



KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE E TË LIRIVE TË NJERIUT
COUNCIL FOR THE DEFENCE OF HUMAN RIGHTS AND FREEDOMS

Rr. Nëna Terezë nr. 24/2 – I/I, Prishtinë-Kosovë; tel. 381 (0) 249006 fax: 381 (0) 38 244029

E-mail: kmdl原因@gmail.com; <http://www.cdhrf.org>

Prot. Nr.254/2018

Informatë e KMDLNj – së:

GJENDJA E KËNAQSHME NË SHTËPINË E KOMUNITIT PËR PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË GRAÇANICË !

Monitorues të KMDLNj-së, në kuadër të mandatit monitorues, vizituan Shtëpinë për Komunitete për Persona me Aftësi të Kufizuar për t'u informuar për problemet eventuale që mundë t'i kenë në aspektin e trajtimit, kushteve fizike në objektin ku qëndrojnë si dhe kërkimit të mundësive për t'iu ndihmuar në të ardhmen. Kjo shtëpi e komuniteteve është nën kompetencë dhe përkujdesje të MPMS.

Personeli përkujdesës në këtë shtëpi e informoi KMDLNj-në se në përgjithësi gjendja është e mirë, furnizimi me barëra është i kënaqshëm sikur edhe me artikuj ushqimorë. Shërbimet shëndetësore ofrohen në përputhje me nevojat që i kanë dhe ka staf të mjaftueshëm mjekësorë për shërbimet e domosdoshme ndërsa, për raste më të ndërlikuara dërgohen në Shtëpinë e Shëndetit në Graçanicë apo në Prishtinë.

Sipas nevojës, specialisti i fushës përkatëse vjen me urgjencë kurse, një herë në javë i bënë vizitat e rregullta. Objekti sigurohet nga dy punëtorë të sigurimit që paguhet nga buxheti i komunës së Graçanicës. Është nevojë që të përmirësohet furnizimi me pampers për shkak të gjendjes shëndetsore të tyre sikur që kërkohet të angazhohet një kuzhinierë me orarë të plotë të punës.

Problemi i identifikuar edhe më parë është prania e qenve endacakë rreth dhe afër objektit e që i shqetëson edhe rezidentët ashtu edhe stafin përkujdesës.

Më parë, afër objektit ka qenë i vendosur azili për qenë endacakë i cili tani është zhvendosur në tjetër lokacion mirëpo, qytetarët e painformuar për ndryshim të lokacionit ende i sjellin qentë endacakë në këtë lokacion dhe i lënë aty.

Në përgjithësi, KMDLNj vlerëson se gjendja në këtë Shtëpi të Komunitit për Persona me Aftësi të Kufizuar është në përputhje me standardet minimale për këtë kategori të cenueshme, ndaj tyre

nuk ka shkelje të drejtave të njeriut sepse stafi i angazhuar është në nivel të detyrës dhe i përkushtuar për punën që e bënë.

KMDLNj edhe më tutje do të vazhdojë të monitorojë këtë Shtëpi të Komunitit dhe qendrat tjera në Kosovë ku janë vendosur grupet e cenueshme apo të marginalizuara.

20 dhjetor 2018

Shërbimi për Informim